



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI JURIDIK**

STUDIMET MASTER

PLANPROGRAMI I LËNDËS

**KONTROLLI GJYQËSOR I PUNËS SË
ADMINISTRATËS – ASPEKTE
KRAHASIMORE**

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Kontrolli Gjyqësor i Punës së Administratës – Aspekte Krahasimore
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	2024/25
Numri i orëve në javë:	3+1
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	//
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Dr. Islam Pepaj
Detajet kontaktuese:	islam.pepaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Studimi i gjyqësisë administrative iu mundëson studentëve që të avancojnë njohuritë e tyre lidhur me kontrollin gjyqësor të veprimtarisë administrative, përkatësisht procedurën e konfliktit administrativ.</p> <p>Në çdo shtet demokratik, rregullohet organizimi i gjyqësisë administrative dhe procedura e kontrollit të ligjshmërisë së vendimmarrjes administrative sipas modeleve tashme të njohura të gjyqësisë administrative. Në këtë drejtim, studentët do të njihen me Modelin francez, përmes së cilit kontrollohet ligjshmëria e vendimmarrjes administrative nga gjykatat e veçanta administrative; Modelin anglez, përmes së cilit kontrollohet ligjshmëria e vendimmarrjes administrative nga gjykatat e rregullta dhe me Modelin gjerman, përmes së cilit kontrollohet ligjshmëria e vendimmarrjes administrative përmes një kombinimi të modelit francez me atë anglosakson. Gjithashtu, rëndësi do ti kushtohet edhe modelit kosovar të gjyqësisë administrative.</p> <p>Në këtë kurs i është kushtuar rëndësi e veçantë edhe standardeve globale të mbrojtjes së të drejtave të njeriut përmes gjyqësisë administrative.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i studimit të kësaj lënde është përqendruar në çështje teorike dhe praktike të kontrollit gjyqësor të veprimtarisë administrative në Republikën e Kosovës si dhe në aspektin krahasimor.</p> <p>Qëllimi themelor i studimit të kësaj lënde është që studentët të njoftohen me teorinë dhe praktiken e kontrollit gjyqësor të veprimtarisë administrative si dhe me zgjidhjet teorike dhe ligjore të kontrollit të</p>

	administratës në vendin tonë duke e krahasuar gjyqësinë administrative me vendet e tjera.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Në përfundim të kësaj lënde, synohet që studentët të familjarizohen më tepër për sistemet juridike të kontrollit gjyqësor të veprimtarisë administrative në përgjithësi dhe formën e aplikimit të institutit të Gjyqësisë Administrative në Republikën e Kosovës në veçanti.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënimit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Javë	Gjithsej
Ligjërata	3	1/15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	1/14	28
Punë praktike	1	1/14	14
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/14	14
Ushtrime në teren	1	1/6	6
Kollokfiume,seminare	3	3/3	9
Detyra të shtëpisë	1	1/10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	1/15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	1	1/15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	1/1	3
Projektet,prezantimet ,etj	3	1/4	12
Totali			171
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Lënda do të mësohet përmes:</p> <p>Trajtimit teorik të sistemeve juridike të kontrollit gjyqësor të veprimtarisë administrative.</p> <p>Trajtimit krahasues të çështjeve duke evidentuar mangësitë dhe përparësitë në lidhje me këtë fushë në Kosovë dhe mundësitë për reformë.</p> <p>Diskutimit të rasteve konkrete nga veprimtaria e administratës Publike në Kosovë.</p> <p>Prezantimeve nga ana e studentëve të temave të caktuara nën mbikëqyrjen e Profesorit dhe hapja e debatit (mësimi interaktiv).</p> <p>Trajtimi i shembujve të ndryshëm me qëllim të lehtësimit dhe të kuptuarit të lëndës nga studentët.</p>		
Metodat e vlerësimit:	Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim:		

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësimi i parë 20% ▪ Vlerësimi i dytë 20% ▪ Punimi seminarik, detyrat e shtëpisë, puna praktike ose angazhimet tjera 20% ▪ Vijimi i rregullt 10% ▪ Provimi final 30% <p>- Totali 100%</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<p>- Islam Pepaj, Kontrolli gjyqësor i vendimmarrjes administrative në Republikën e Kosovës në raport me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Prishtinë, 2024.</p> <p>- Esat Stavileci, Agur Sokoli, Mirlinda Batalli, E drejta administrative – Administrata, Kontrolli i punës së administratës dhe përgjegjësia e saj, Kompjuterizimi i administratës, Prishtinë 2010.</p> <p>- Agur Sokoli, Kontrolli i punës së administratës dhe përgjegjësia politike e saj, Prishtinë, 2009</p> <p>Esat Stavileci, Gjyqësia administrative, mundësitë dhe përparësitë, 2011.</p> <p>- Mirlinda Batalli & Islam Pepaj, Increasing Efficiency in Public Administration Through a Better System of Administrative Justice, 2017.</p> <p>- Mirlinda Batalli & Islam Pepaj, The Impact of the European Convention on Human Rights in the Field of Administrative Justice, 2017.</p> <p>- Islam Pepaj, Review of Administrative Justice in the Republic of Kosovo, 2015.</p> <p>- Ermir Dobjani; Erlir Puto; Elsa Tostka; Erajd Dobjani, Kontrolli mbi administratën publike, Tirane, 2013.</p>
Literatura shtesë:	
	<p>Kushtetuta e Republikës së Kosovës.</p> <p>Ligji për Konfliktet Administrative i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-182.</p> <p>Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 05/L -031.</p> <p>Ligji për Gjykatën Komerciale i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-015.</p> <p>Komentari Ligjor i Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative të Republikës së Kosovës. I qasëshëm në këtë link: https://komentari-lppa.net</p> <p>Kodi i procedurave administrative të Shqipërisë.</p> <p>Komentari i Kodit të procedurave administrative,</p>

	Tiranë. 2004.
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Informimi për përmbajtjen e lëndës mësimore, literaturën dhe burimet juridike.
Java e dytë:	Kuptimi dhe rëndësia e gjyqësisë administrative
Java e tretë:	Format e kontrollit të veprimtarisë administrative <ul style="list-style-type: none"> - Kontrolli juridik i administratës - Kontrolli politik i administratës - Kontrolli administrativ i administratës - Kontrolli i jashtëm i administratës
Java e katërt:	Kontrolli gjyqësor administratës <ul style="list-style-type: none"> - Lindja dhe zhvillimi historik i kontrollit gjyqësor të administratës
Java e pestë:	Vështrim burimor mbi origjinën e modeleve të Gjyqësisë Administrative <ul style="list-style-type: none"> - Modeli francez i gjyqësisë administrative - Modeli anglez i gjyqësisë administrative - Modeli gjerman i gjyqësisë administrative
Java e gjashtë:	Ndikimi i akteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në fushën e Gjyqësisë Administrative
Java e shtatë:	Jurisprudenca e GJEDNJ-së lidhur me kontrollin gjyqësor të vendimmarrjes administrative
Java e tetë:	Drejtësia administrative në Republikën e Kosovës dhe jurisprudenca Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
Java e nëntë:	Procedura e konfliktit administrativ <ul style="list-style-type: none"> - Parimet e procedurës së konfliktit administrativ - Padia në konfliktin administrativ - Palët - Afati i padisë - Përmbajtja e padisë
Java e dhjetë:	Rrjedha e procedurës sipas padisë procedurën e konfliktit administrativ <ul style="list-style-type: none"> - Procedura paraprake sipas padisë - Procedura e rregullt sipas padisë - Hedhja poshtë e padisë për shkaqe formale - Pezullimi i procedurës së konfliktit administrativ

Java e njëmbëdhjetë:	Përfundimi i konfliktit administrativ në shkallë të parë - Përfundimi i konfliktit administrativ me aktgjykim - Përfundimi i konfliktit administrativ me aktvendim - Aktgjykimi mbi refuzimin e padisë - Aktgjykimi mbi miratimin e padisë - Pjesët përbërëse të aktgjykimit
Java e dymbëdhjetë:	Mjetet juridike në procedurën e konfliktit administrativ
Java e trembëdhjetë:	Zvarritja e procedurës së konfliktit administrativ – shkelja e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm
Java e katërbëdhjetë:	Ankesa kushtetuese kundër akteve dhe veprimeve të administratës.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Respektimi i orarit në ligjëratë dhe ushtrime; ▪ Mos-lëshimi i sallës gjatë ligjëratave ose ushtrimeve; ▪ Ruajtja e integritetit akademik; ▪ Ruajtja e disiplinës gjatë procesit mësimor; ▪ Respektimi i rregullave gjatë provimit.